



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME I AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 890/2016

në lidhje me

*Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës si dhe e drejta në shfrytëzimin
e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë*

drejtuar

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

**Për: Z. Skënder Reçica, Ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**

**Kopje: Z. Ramush Haradinaj, Kryeministër
Qeveria e Kosovës**

Prishtinë, më 27 shkurt 2018

Qëllimi i Raportit

1. Raporti është i bazuar në rastin A.890/2016, dhe mbështetet në pretendimet, faktet dhe dëshmitë e ankuesit të paraqitura në IAP, lidhur me ndërprerje të pensioneve kontributpaguese. Përveç ankesës në fjalë Avokati i Popullit ka pranuar edhe ankesa të natyrës së njëjtë. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që qytetarëve t'u ofrohet mundësia e garantuar ligjore dhe kushtetuese në shfrytëzim të pensioneve kontributpaguese si e drejtë në pronë.
2. Raporti analizon kornizën ligjore në aspektin e ushtrimit të së drejtës në pension kontributpagues të moshës, në raport me të drejtën në ushtrimin e pensioneve tjera në bazë të Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre dhe Ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
3. Po ashtu, ky Raport argumenton se ushtrimi i të drejtës në pensionin kontribut pagues të moshës paraqet ushtrim të së drejtës në pronë, në bazë të nenit 1, Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme "KEDNJ"), në raport me kushtëzimin e ushtrimit të së drejtës në këtë pension, në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (në tekstin e mëtejme Ligji për Skemat Pensionale).

Baza Ligjore

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme "Kushtetuta") në bazë të nenit 135, paragrafi 3, përcakton se *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore"*.
5. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *"Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut"* (neni 16, paragrafi 4);
 - *"të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre si dhe të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet për qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla"* (neni 18, par 1, nën-paragrafi 1 dhe 2);
 - *"të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit"* (neni 18, par. 1, nën-paragrafi 5);

- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, par. 1, nën-paragrafi 6);
- “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës” (neni 18, par. 1, nën-paragrafi 7);
- “t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv” (neni 18, par. 1, nën-paragrafi 9);
- “t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës” (neni 18, par. 3).

Rrethanat e rastit

6. Me krijimin e skemave tjera të veçanta pensionale shumë nga ankuesit kanë aplikuar dhe kanë fituar edhe të drejta dhe benifite nga këto skema dhe për një kohë të gjatë kanë qenë përfitues nga dy skema pensionale, si në pensione kontributpaguese ashtu dhe në pensione tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.
7. Nga viti 2016, ankuesve me vendime nga MPMS, pa paralajmërim apo konsultë për heqje vullnetare dorë nga njëri pension i janë shfuqizuar dhe i janë ndërprerë pensionet kontributpaguese të moshës.
8. Ankuesit pretendojnë se kishin parashtrua ankesë pranë Komisionit për Ankesa të MPMS por nuk kishin pranuar përgjigje.
9. Avokati i Popullit nëpërmjet shkresave disa herë i është drejtuar MPMS për të kërkuar informata lidhur bazën ligjore të ndërprerjes së pensionit kontributpagues, dhe arsyet për mos përgjigje në ankesat e qytetarëve drejtuar Komisionit të Ankesave në MPMS. Mirëpo as Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje në asnjërën nga shkresat e dërguara.
10. Në takimin e realizuar me 6 shkurt 2018 me përfaqësuesit e MPMS u diskutua ndër të tjera edhe lidhur me çështjet e ngritura nga Avokati i Popullit në shkresat e lartshënuara. Në këtë takim përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u njoftuan se MPMS kishte ndërprerë pensionet duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit për Skemat Pensionale.

Sfondi ligjor

11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 3 [Barazia para Ligjit], ndër të tjera përcakton se Republika e Kosovës qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht.
12. Neni 24 i Kushtetutës, ndalon diskriminimin, duke theksuar në paragrafin 2 që: “*Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës... ()...pronës..., ose ndonjë statusi tjetër personal*”.
13. Neni 46 i Kushtetutës, paragrafi 1, përcakton se: “*E drejta e pronës është e garantuar*”.
14. Sipas nenit 55, paragrafi 1 i Kushtetutës: “*Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me*

këtë Kushtetutë, ***mund të kufizohet vetëm me ligj***”.

15. Në të njëjtën mënyrë, neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përcakton se: *“Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij, përveçse . . . në kushtet e parashikuara nga ligji”*.
16. Sipas Kushtetutës, neni 22, KEDNJ është një ndër tetë instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, që zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.
17. Më tutje, sipas nenit 53 të Kushtetutës: *“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
18. Ligji për Skemat Pensionale, në nenin 8 përcakton kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pensionin bazik të moshës. Paragrafi 3 i nenit 8, përcakton që: *“Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontribut pagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj”*.
19. Për më tepër, bazuar në nenin 16 të Ligjit për Skemat Pensionale: *“Personat të cilët janë përfitues të të cilit do pension të Skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, nën asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen dhe administrohen nga Ministria”*.
20. Ligji Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (në tekstin e mëtejshëm: *Ligji për Vlerat e Luftës*), në nenin 4 përcakton se: *“Varësisht nga njohja dhe rregullimi i statusit, kategorive të trajtuara në këtë ligj, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme do t’ju sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së”*.
21. Sipas nenit 5 të Ligjit për Vlerat e Luftës, pensionet e përcaktuara me këtë ligj janë: pensioni familjar, pensioni invalidor personal dhe pensioni invalidor familjar. Sipas paragrafit 1.4 të këtij neni: *“përfituesit e pensioneve sipas paragrafit 1.1 dhe 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është përcaktuar me ligj”*.
22. Në anën tjetër, neni 23, paragrafi 3, i Ligjit për Vlerat e Luftës, përcakton që: *“Shfrytëzuesit e pensionit bazë, mund të realizojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet e përcaktuara me këtë ligj, nëse i përmbushin kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të këtij ligji”*.
23. Në bazë të Ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *“Ligji për Veteranët e UÇK-së”*), në nenin 1 përcakton se: *“Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në beneficione të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës”*.
24. Më tutje, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Veteranët e UÇK-së rregullohet realizimi i të

drejtës në pension dhe beneficione, duke përcaktuar që: *“Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme, i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së”*.

25. Ndërsa, neni 16 i Ligjit për Veteranët e UÇK-së, në paragrafin 2 përcakton se: *“Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë”*.

Analiza Ligjore

26. Avokati i Popullit vë në dukje se e drejta në pension kontributpagues të moshës rregullohet me Ligjin për Skemat Pensionale, ndërsa e drejta në pensione dhe benefite për kategoritë e dala nga lufta rregullohet me Ligjin për Vlerat e Luftës dhe me Ligjin për Veteranët e UÇK-së.
27. Mirëpo, përkundër faktit që personi i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj për shfrytëzimin e të drejtës në pensionin kontributpagues të moshës ose të ndonjë pension tjetër të financuar nga shteti, ai mund të privohet nga e drejta për gëzimin të pensioneve të garantuara me ligj. Kjo rrjedh nga dispozitat ligjore sipas të cilave: *“personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj”* (Neni 8, par 3, i Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.
28. Në këtë drejtim mund të konstatohet se shfrytëzimi i një pensioni përjashton të drejtën në ushtrimin e pensionit tjetër. Një gjë e tillë nënkupton që veterani i UÇK-së nuk do mund të ushtrojë të drejtën në pensionin i cili i përket në bazë të kontributit të dhënë gjatë luftës, të përcaktuar me Ligjin për Vlerat e Luftës, në qoftë se i njëjti ushtron të drejtën në pensionin kontributpagues të moshës. Individidi në këtë rast do duhej të zgjedhë në mes të shfrytëzimit të pensionit ku ka kontribuar ashtu siç ka paraparë ligji në fuqi, dhe shfrytëzimit të pensionit që i takon po ashtu në bazë të ligjit dhe kontributit që ka dhënë në luftën e UÇK-së.
29. Në këtë rast fokusi duhet të vihet të pensioni kontributpagues të moshës për dy arsye:
- E para: në bazë të Ligjit për Skemat Pensionale, ky pension i takon personit që ofron dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; dhe
- E dyta: që kontributet e paguara në bazë të pikës 1) konsiderohen e drejtë në pronë në bazë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
30. Rrjedhimisht, kushtëzimi në bazë të ligjit në ushtrimin e së drejtës mbi pensionin kontributpagues të moshës, me ushtrimin mbi një pension tjetër shkakton shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.
31. Nga kjo që u tha më lart rrjedh konstatimi që pensioni kontributpagues i moshës mund t'i mohohet personit të caktuar që ushtron të drejtën edhe në një pension tjetër, pasi që

korniza ligjore lejon ushtrimin e së drejtës në një pension të vetëm. Ajo çka duhet të theksohet këtu është që dispozitat ligjore nuk qartësojnë, kush bën zgjedhjen e pensionit të cilin në vijim do ta gëzojë. Ligji për Vlerat e Luftës në mënyrë të qartë ia jep këtë të drejtë personit i cili i plotëson kushtet e parapara që t'a ushtrojë të drejtën në njërin nga pensioneve që parashihen me këtë ligj. Megjithatë, e njëjta nuk reflekton edhe brenda Ligjit për Skemat Pensionale.

32. Avokati i Popullit vlerëson se kufizimi i tillë i të drejtës në shfrytëzimin e pensionit kontributpagues të moshës ose ndonjë pensioni tjetër nga shteti, përkundër faktit se plotësohen kushtet e përcaktuara sipas ligjit, paraqet shkelje të *së drejtës së pronës*.

33. Avokati i Popullit konsideron se në mënyrë që të diskutohet mbi mohimin e së drejtës në pronë në bazë të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së duhet pasur parasysh që e drejta në pronë mund të kufizohet nga ana e shtetit, por vetëm në rastin e interesit të përgjithshëm.

34. Në lidhje me këtë, në mënyrë që të konstatohet shkelja e nenit 1, Protokollit nr.1, duhet pasur parasysh pyetjet si në vijim:

1. *A është ndërhyrja e shtetit proporcionale, respektivisht a ekziston një balancë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtës fundamentale të individit?*

2. *A është interferenca në pajtim me parimin e ligjshmërisë? dhe*

3. *A i shërben ndërhyrja objektivit legjitim në interesin publik apo të përgjithshëm?*

Në qoftë se përgjigja në të gjitha këto pyetjet është “jo”, vlerësohet se ndërhyrja është në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.¹

35. Kur flitet për nenin 1 të Protokollit Nr.1 duhet pasur të qartë që në bazë të praktikës së GJEDNJ-së, interpretimi i këtij neni dhe vetë konceptit të pronës është shumë i gjerë. Bazuar në praktikën e deritanishme të GJEDNJ-së, pensionet bien ndër aplikimin e këtij neni, e kjo për shkak të lëndës *Muller v Austria*². Gjatë diskutimit mbi rastin, GJEDNJ ka gjetur që e drejta në ushtrimin e pensionit kontributpagues nuk është e drejtë e paraparë *per se* me KEDNJ. Sido që të jetë, GJEDNJ ka gjetur që përmes pagimit të kontributeve në fondin pensional, personi në fjalë krijon të drejtë të pronës. Përmes analogjisë, e njëjta aplikohet edhe në rast të pagimit të kontributeve të natyrës vullnetare. Në dobi të asaj që është thënë deri tani flet edhe lënda *Gaygusuz v Austria*³ ku është bërë lidhja në mes kontributeve dhe pensionit, andaj personit që ka paguar kontribute pensionale nuk mund t'i mohohet e drejta në ushtrimin e atij pensioni. Po ashtu, në bazë të lëndës *Van Raalte v*

¹ Monica Carss-Frisk, The Right to Property, A guide to the implementation of Article 1 of Protocol No.1 to the European Convention on Human Rights; human rights handbook No.4, Directorate General of Human Rights, Council of Europe, November 2001, pg.10.

² Muller v Austria, Vendimi i datës 5 janar 2007, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["muller v austria"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-77265"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

³ Gaygusuz v Austria, Vendimi i datës 16 shtator 1996, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["gaygusuz v austria"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-58060"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{) Në vendimin mbi lëndën Azinas v Cyprus të datës 20 qershor 2002, GJEDNJ ka konfirmuar që, përderisa e drejta në pension nuk është si e tillë e përfshirë në KEDNJ, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, e drejta në pension që është e bazuar në punësim mund të konsiderohet “e drejtë në pronë”. Kjo aplikohet në rast të pagesës së kontributeve, ku në bazë të praktikës së GJEDNJ-së: “një gjë e tillë ndodh për shkak të faktit që punëdhënësi paguan contribute pensionale, që mund të merret që bien nën kushtet e kontratës së punës”.

*Netherlands*⁴, neni 1 i Protokollit Nr.1 aplikohet atëherë kur flitet për pagesën e kontributeve pensioneale, sidomos për faktin që obligimi i tillë i pagesës së kontributeve dhe taksave imponohet nga shteti.

36. Në fund, marrë parasysh diskrecionin që shteti ka tek arsyetimi i aplikueshmërisë së trajtimeve të ndryshme në raste të ngjashme, GJEDNJ ka gjetur në lëndën *Wessels-Bergervoet v the Netherlands*⁵ që e drejta në ushtrimin e pensionit kontributpagues të moshës bie nën fushëveprimin e nenit 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së.
37. Bazuar në atë që është thënë më lart, mund të vihet re që legjislacioni vendor nuk mund assesi të kushtëzojë ushtrimin e së drejtës në pensionin kontributpagues të moshës, e kjo duke marrë parasysh praktikën e GJEDNJ-së dhe prioritetin e saj ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike. Duke vepruar në kundërshtim me këtë, legjislacioni i Republikës së Kosovës vepron në drejtim të diskriminimit në bazë të pronës, duke kushtëzuar ushtrimin e së drejtës në këtë pension në rast të pranimit të ushtrimit të një pensioni tjetër të paraparë me skemën pensioneale të shtetit.
38. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, nuk mund të flitet as për mundësinë e zgjedhjes alternative ndërmjet pensioneve në dispozicion, pasi që është parë që praktika e GJEDNJ-së nuk lejon kushtëzimin e ushtrimit të së drejtës në pensionin kontributpagues të moshës.
39. Përveç se u tha më lart, e drejta për ta gëzuar pensione, në veçanti e drejta në pension kontributpagues, është një e drejtë e fituar (acquired right) që paraqet një doktrinë juridike sipas të cilës një e drejtë e fituar në bazë të normave ligjore të caktuara nuk mund të kufizohet me ligje apo akte të nxjerra më vonë. Doktrina e së drejtës së fituar lidhet ngushtë me parimin e sigurisë juridike. Prandaj, kufizimi i të drejtës në gëzimin e pensionit kontributpagues në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti shkel parimin e sigurisë juridike për shkak se kjo e drejtë është fituar në bazë të ligjeve të mëparshme për pensionet dhe nuk mund të ndryshohet me asnjë ligj tjetër.
40. Në fund, Avokati i Popullit vë në dukje se mangësitë në ligje ndikojnë në sundimin e ligjit, përkatësisht në sigurinë juridike. Me sigurinë juridike kërkohet që rregullat ligjore të jenë të qarta dhe precize me të cilat synohet parashikimi i situatave, mos miratimi nga Kuvendi i ligjeve të dykuptimta, dhe se veprimet ose premtimet e dhëna individëve nga shteti (*pritjet legjitime*), duhet të respektohen. Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji të zbatohet në praktikë dhe që ligji të jetë i zbatueshëm.⁶
41. Së këndejmi Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që në pajtim me kompetencat dhe autorizimet e saj t'i propozojë Qeverisë së Republikës së Kosovës ndryshimin e:

1. Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht fshirjen e:


⁴ Van Raalte v Netherlands, vendimi I datës 21 shkurt 1997, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["van raalte v the netherlands"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-58031"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

⁵ Wessels-Bergervoet v the Netherlands, vendim I datës 4 qershor 2002, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"fulltext":\["wessels-bergervoet v the netherlands"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-60493"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

⁶ EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) REPORT ON THE RULE OF LAW Adopted by the Venice Commission at its 86th plenary session (Venice, 25-26 March 2011) (44-51)

- a) paragrafit 3 të nenit 8 të këtij ligji, i cili përcakton se: “*personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj*”; dhe
- b) nenit 16 të këtij ligji, i cili përcakton se: “*Personat të cilët janë përfitues të të cilit do pension të Skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, nën asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen dhe administrohen nga Ministria*”.
2. **Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, përkatësisht fshirjen e paragrafit 1.4 të nenit 5 të ligjit, i cili përcakton se:** “*përfituesit e pensioneve sipas paragrafit 1.1 dhe 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është përcaktuar me ligj*”.
3. **Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kosovës, përkatësisht fshirjen e paragrafit 2 të ligjit i cili përcakton se:** “*Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë*”

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit